



NJOFTIM PËR SHTYP

Impiante bashkëkohore për menaxhimin me mbeturinat dhe sistemet infrastrukturore me ujë, janë pjesë e vizitave në teren që u realizuan nga delegacioni i udhëhequr nga Aco Ristov, kryetari i i Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale (KRrE) gjatë vizitës së punës në Republikën Popullore të Kinës.

Delegacioni, në përbërjen e të cilit janë: anëtarët e KRrE-së, Ane Lashkovska, zëvendës-ministre e mjedisit jetësor, drejtorët e disa Ndërmarrjeve Publike Komunale, Inspektoratit të Mjedisit Jetësor dhe Shoqata e Ofruesve të Shërbimeve Komunale - ADKOM, patën mundësi të njihen me një sistem të vjetër prej më shumë se 2 000 vite për menaxhimin me resurset e ujit, i cili mundëson furnizimin me ujë në rajone më të larta dhe njëkohësisht pengon vërshimet në rajonet më të ulëta.

U vizituan edhe kapacitetet me teknologji më bashkëkohore për prodhimin e energjisë elektrike nga mbetjet komunale. Njashtu u paraqitën edhe zgjidhjet inovative për trajtimin e mbetjeve, rritjen e efikasitetit energjetik dhe uljen e ndikimit mbi mjedisin jetësor, në përputhje me konceptin e ekonomisë cirkulare.

Vizita e punës u realizua nën organizimin e Institutit të Biogazit, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Punëve Rurale, në bashkëpunimi me ambasadën e Republikës Popullore të Kinës.

Në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore, KRrE-së iu dha autorizimi i zgjeruar dhe iu dha detyra për rregullimin e shërbimeve për menaxhimin me mbeturina komunale.

12.6.2026



ул. Македонија нр. 25, палата Лазар Поп-Трајков - 6^{тм} спрат • 1000 Скопје,
Република Северна Македонија
Централа 02 3233-580 • Факс: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk

Rr. Македонија нр. 25, pallati L Lazar Pop-Trajkov – kati i 6 • 1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë së Veriut
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk